

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA SHKJEZI KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 82151/17)

VENDIM

STRASBURG

24 tetor 2024

Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Shkjezi kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma, *kryetar,*

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëskancelare në detyrë e Seksionit,*

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 3 tetor 2024,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në këtë datë:

PROCEDURA

1. Çështja vjen pas depozitimit në Gjykatë të një kërkesë kundër Shqipërisë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa), më 27 nëntor 2017.

2. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u njoftua për kërkesën.

FAKTET

3. Detajet e kërkesës dhe informacioni në lidhje me kërkesën jepen në tabelën bashkëngjitur.

4. Më 11 mars 2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë urdhëroi rikthimin e kërkesës në pozicionin e saj të mëparshëm të punës në Ministrinë e Financave dhe i dha të drejtën të marrë pagat e papaguara (vendimi 2014). Ky vendim mori formë të prerë më 19 maj 2016, kur Gjykata e Lartë e refuzoi ankimimin e Ministrisë.

5. Pas rikthimit të saj, kërkesja mori pagesën e fundit të pagave të papaguara në qershor 2020. Kështu procedurat përmbarimore zgjatën pothuajse mbi katër vjet, nga maji 2016 deri në qershor 2020.

6. Më 14 maj 2018, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë urdhëroi Ministrinë e Financave që t'i paguante kërkeses kompensim për mosekzekutimin e plotë të vendimit të vitit 2014.

7. Ministria e ankimoi dhe më 21 shtator 2023, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë (vendimi 2023) modifikoi shumën e kompensimit dhe la në fuqi pjesën tjetër të vendimit.

8. Pas ankimit nga Ministria e Financave, më 4 prill 2024, çështja u transferua në Gjykatën e Lartë ku është aktualisht në pritje për rishikim.

LEGJISLACIONI

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

9. Kërkesja u ankua për ekzekutimin me vonesë të vendimit 2014. Ajo u mbështet në paragrafin 1, të nenit 6 të Konventës.

10. Qeveria parashtoi që nisur nga vendimi 2023, çështja ishte zgjidhur dhe kërkesa duhej të fshihej nga lista e çështjeve të Gjykatës sipas nenit 37 § 1 (b) të Konventës.

11. Gjkata thekson se ndërsa qeveria u mbështet në vendimin 2023, ajo nuk e pranoi atë dhe e ankimoi përpara Gjykatës së Lartë ku ankimi është akoma në pritje për rishikim. Prandaj, çështja nuk është zgjidhur sepse Gjykata e Lartë mund të pranojë ankimin e qeverisë dhe të vendosë kundër kërkuësës. Kështu, rrëzohet kundërshtimi i qeverisë në këtë aspekt. Gjykata nuk harron faktin që çështja, në lidhje me kompensimin për ekzekutimin me vonesë, ka qenë në pritje përpara gjykatave të brendshme për më shumë se gjashtë vjet pa zgjidhje përfundimtare.

12. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë do të marrë parasysh gjetjet sipas këtij vendimi për të vendosur për çështjen në pritje përpara saj (krahasoni me *Sharxhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 10613/16, § 197, 11 janar 2018, me referenca të mëtejshme).

13. Në lidhje me themelin, Gjykata përsërit që ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë e pandarë e “seancës gjyqësore” për qëllime të nenit 6. Gjithashtu, ajo i referohet praktikës gjyqësore në lidhje me mosekzekutimin ose ekzekutimin me vonesë të vendimeve të brendshme të formës së prerë (shihni *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, 40, *Raporte të Vendimeve* 1997 II).

14. Në çështjet kryesuese *Qufaj Co sh.p.k. kundër Shqipërisë* (nr. 54268/00, §§ 38–45, 18 nëntor 2004) dhe *Gjyli kundër Shqipërisë* (nr. 32907/07, §§ 43–47, 29 shtator 2009), Gjykata tashmë ka gjetur shkelje në lidhje me probleme të ngjashme me problemet e kësaj çështjeje.

15. Për t’ju kthyer fakteve specifike të kësaj çështjeje, Gjykata gjen se autoriteteve ju deshën më shumë se katër vjet për të ekzekutuar vendimin 2014 (shihni paragrafët 5 më sipër) dhe se ato nuk i bënë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të ekzekutuar atë vendim në kohën e duhur.

16. Prandaj ankimi është i pranueshëm dhe zbulon shkelje të paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës.

II. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

17. Duke pasur parasysh dokumentet që dispononte dhe praktikën e saj gjyqësore (shihni, në veçanti, *Qufaj Co sh.p.k.*, cituar më sipër, §§ 46–48 dhe *Gjyli*, të cituar më sipër, §§ 62–76), Gjykata e konsideron të arsyeshme dhënien e shumës së treguar në tabelën e bashkëngjitur.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

1. *Shpall* kërkesën të pranueshme;

2. *Vendos* që kjo kërkesë zbulon shkelje të paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës, në lidhje me ekzekutimin me vonesë të vendimit përfundimtar në favor të kërkuësës;

3. *Vendos*:

a) që shteti i paditur t’i paguajë kërkuësit, brenda tre muajve, shumën e treguar në tabelën bashkëngjitur, që do të konvertohet në monedhën e shtetit të paditur me normën në fuqi në datën e shlyerjes;

b) që nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje të paguhet kamatëvonesë e thjeshtë për shumat e mësipërme, sipas normës së njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 24 tetor 2024, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSKANCELARE NË DETYRË

Peeter Roosma
KRYETAR

SHTOJCË

Kërkesa që paraqet ankimin sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës (mosekzekutimi ose ekzekutimi me vonesë i vendimeve të brendshme)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuarit Viti i lindjes	Legjislacioni i brendshëm përkatës	Data e fillimit të periudhës së mosekzekutimit	Data e mbarimit të periudhës së mosekzekutimit Kohëzgjatja e procedurave të ekzekutimit	Dëshmipërblimi i brendshëm	Shuma e dhënë për dëmin jopasuror për kërkuarin (në euro) ¹
82151/17 27.11.2017	Sonila SHKJEZI 1973	Vendim i datës 11 mars 2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë	19.5.2016	Qershor 2020 4 vjet dhe 11 ditë	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me vendimin nr. 953, datë 11.3.2014, urdhëroi Ministrinë e Financave të rikthejë kërkuarën në pozicionin e saj të mëparshëm (ose të ngjashëm) në shërbimin civil dhe t'i paguajë asaj pagat e papaguara.	2.400

¹ Plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuarit.